



BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Janar 2023

BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Janar 2023

AKTIVITETET E KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

**(Në këtë edicion të këtij Buletini pasqyrohen
aktivitetet për muajin janar të vitit 2023)**

Mbahet takimi i parë për vitin 2023 i Komisionit për Administrimin e Prokurorive

Komisioni për Administrimin e Prokurorive mbajti takim të radhës, të parin për vitin 2023, me ç'rast u tha do të kërkohet nga kryeprokurorët, administratorët dhe shefat e shkrimorëve të prokurorive që të zbatojnë me përpikëri rekomandimet e Grupit punues për monitorimin e zbatimit të SMIL-it, me ç'rast do të kërkohet nga ana e tyre raportim të vazhdueshëm lidhur me aktivitetet e realizuara që kanë të bëjnë me implementimin e SMIL-it.



Gjithashtu, u theksua se çdo mosangazhim lidhur me kërkesat e lartcekura do të pasojë me veprime disiplinore ndaj çdo përgjegjësi eventual dhe se qëllimi kryesor i ndërmarrjes së këtyre veprimeve është ngritja e kualitetit të këtyre të dhënave, pasi që largimi i regjistrave fizikë, që është objektiv i Këshillit Prokurorial të Kosovës, mund të arrihet vetëm kur kemi zbatim të saktë dhe të plotë të SMIL-it.

Njoftim nga Këshilli Prokurorial i Kosovës

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) ka njoftuar opinionin publik se menjëherë pas rastit të fundit të vrasjes së ndodhur në Prizren ku i dyshuar është Dibran Hoxhaj, ka kërkuar nga Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore të Prizrenit të përgatisë raport lidhur me gjitha veprimet prokuroriale të ndërmarra ndër vite ndaj tij.

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të kompetencave ligjore që ka, do të trajtojë me kujdes të gjitha



veprimet e ndërmarra ndër vite nga prokuroria përkatëse ndaj Dibran Hoxhaj dhe çdo lëshim eventual do të sanksionohet në bazë të akteve ligjore në fuqi.

Ministrja Haxhiu vazhdon me deklarata të pavërteta për sistemin prokurorial të Kosovës

Këshilli Prokurorial i Kosovës ka kundërshtuar deklaratën e Ministres së Drejtësisë, Albulena Haxhiu, lidhur me, siç thotë ajo, “mosvullnetin e as interesin për trajtimin serioz të krimeve të luftës nga sistemi prokurorial i Kosovës me në krye ish-kryeprokurorin Lumezi”

Në reagimin e KPK-së, thuhet se deklarata e Ministres Haxhiu nuk është e vërtetë, sepse Këshilli Prokurorial i Kosovës ka caktuar katër prokurorë në Departamentin për Krime të Luftës të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës. Për të mbështetur këtë departament, po ashtu, janë caktuar edhe gjashtë bashkëpunëtorë profesionalë dhe dy zyrtarë ligjorë.



Më tej potencohet se, e pavërteta e thënë nga Ministrja Haxhiu është e dëshmuar lehtë, me marrjen e mandatit të ish-Kryeprokurorit Aleksandër Lumezi, janë marrë veprime konkrete si: janë lëshuar 72 urdhërarreste ndërkombëtare për arrestimin e të dyshuarve për krime lufte, janë ndërmarrë veprime konkrete hetimore në drejtim të zbulimit të kryesve të veprave penale dhe kundër urdhërdhënësve, janë ngritur dhjetëra aktakuza, është përgatitur baza e të dhënave në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës për rastet e krimeve të luftës dhe është harmonizuar kjo databazë me atë të Policisë së Kosovës. Me iniciativën e ish- Kryeprokurorit Lumezi

është përgatitur dhe miratuar Strategjia për trajtimin e rasteve të krimeve të luftës. Këto dhe shumë veprime të tjera janë ndërmarrë, janë duke u ndërmarrë në baza ditore për hetimet e krimeve të luftës në Kosovë.

Këshilli Prokurorial i Kosovës vlerëson lart angazhimin dhe gatishmërinë profesionale të ish-Kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi, në forcimin e Prokurorit të Shtetit si një institucioni i qëndrueshëm dhe i gatshëm për t'u ballafaquar me rastet me të rënda në Republikën e Kosovës, të cilat deri në vitin 2015 ishin në kompetencë të EULEX-it. Prandaj, çfarëdo tendence për të mos njohur të arriturat institucionale nënkupton marginalizim të të arriturave shtetërore.

Betohet anëtari i ri i Këshillit Prokurorial të Kosovës nga radhët e Prokurorisë së Apelit

Në takimin e 226-të të Këshillit Prokurorial i Kosovës u mbajt ceremonia e dhënies së betimit të anëtarit të ri të Këshillit nga radhët e prokurorëve të Prokurorisë së Apelit dhe u miratua Plan i Punës së Këshillit Prokurorial të Kosovës për vitin 2023, i cili u prezantua Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit të Sekretariatit të KPK-së.



Këshilli Prokurorial miratoi, gjithashtu, me disa propozime klasifikimin e pozitave të stafit në të gjitha nivelet e administratës së sistemit prokurorial, propozim ky, i cili do të dërgohet në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, pas dekretimit të Ligjit për Pagat në Sektorin Publik.

Anëtarët e KPK-së miratuan edhe: Planin e Komisionit për Vlerësimin e Performancës për vitin 2023 dhe Protokollin për trajnimin e detyrueshëm të prokurorëve me performancë të dobët, si dhe Raportin e Komisionit për Rekrutimin e njëzet e dy prokurorëve të rinj të Shtetit, emrat e të cilëve do të dërgohen për dekretim në Zyrën e Presidentes së Republikës së Kosovës.

KPK kërkon nga Avokati i Popullit referimin e Ligjit për Pagat në Sektorin Publik në Gjykatën Kushtetuese

Këshilli Prokurorial i Kosovës, përmes një komunikate ka njoftuar opinionin publik se iu ka drejtuar me kërkesë Avokatit të Popullit që në zbatim të dispozitave kushtetuese dhe ligjore të referojë Ligjin për Pagat në Sektorin Publik në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

KPK ka pasqyruar në këtë kërkesë komentet e vazhdueshme, të cilat janë bërë në lidhje me këtë ligj.

Me këtë rast, KPK-ja ka konstatuar se, me hyrjen në fuqi të Ligjit për Pagat në Sektorin Publik cenohet pavarësia dhe funksionalizimi i sistemit prokurorial për vetë faktin se kjo çështje është vendosur njëherë me Aktgjykimin numër KO 219/19 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.



Të gjitha pretendimet e ngritura nga KPK-ja, të cilat janë dërguar tek Avokati i Popullit, paraprakisht edhe tek hartuesit e këtij Ligji, janë të mbështetura në aktet dhe praktikat ndërkombëtare, të cilat kanë paraparë në mënyrë taksative se kur mund të zbritet paga e prokurorit të shtetit.

KPK shpreh gatishmërinë e plotë për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit, me qëllim të referimit të këtij ligji në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës.

KPK përkrah hartimin e një ligji për pagat në sektorin publik, i cili duhet të jetë i bazuar në praktikat dhe standardet më të mira ndërkombëtare dhe i cili nuk do të cenojë pavarësinë dhe funksionalizimin e asnjë pushteti.

Mbahet takimi i parë për vitin 2023 i Komisionit mbikëqyrës për monitorimin e rasteve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike

Komisioni mbikëqyrës për monitorimin e rasteve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike mbajti takimin e parë për vitin 2023.

Anëtarët e Komisionit diskutuan për hartimin e Raportit vjetor për vitin 2022, duke analizuar statistikat e dërguara nga secila prokurori dhe duke i krahasuar me rekomandimet e dhëna gjatë vizitave të bëra gjatë vitit 2022 nëpër prokuroritë e Republikës së Kosovës.



Po ashtu, është diskutuar edhe plani i vizitave që do të realizohet nëpër prokuroritë e Republikës së Kosovës për vitin 2023.

Komisioni për Çështje Normative aprovoi Planin e Punës për vitin 2023

Komisioni për Çështje Normative mbajti takimin e tij të parë në vitin 2023, në të cilin aprovoi Planin e Punës për vitin 2023, i hartuar në përputhje me Planin e Punës së KPK-së dhe akteve të tjera juridike.



Po ashtu është shqyrtuar edhe Raporti i monitorimit të akteve nënligjore të sistemit prokurorial, raport ky, i cili është përgatitur pas vizitave të zhvilluara nga Komisioni nëpër prokuroritë, me qëllim të monitorimit të zbatimit të akteve nënligjore.

Zëvendëskryesuesi i KPK-së ka pritur në takim Drejtoreshën e e Projektit EUKOJUST

Zëvendëskryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës ka pritur në takim Drejtoreshën e Projektit EUKOJUST dhe Udhëheqësin e ekipit të Projektit, me ç'rast diskutuan për aktivitetet e projektit dhe bashkëpunimin për implementimin e tyre.

Zëvendëskryesuesi, pasi vlerësoi projektin EUKOJUST, theksoi se sistemi prokurorial i Kosovës është duke përfitur nga ky projekt në shumë drejtime.



Bashkëbiseduesit u pajtuan për vazhdim të bashkëpunimit në realizimin dhe implementimin e Të gjitha aktiviteteve të projektit.

Komisioni aprovoi Planin e personelit për vitin 2023

Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel i KPK-së, në të cilin diskutoi dhe miratoi Planin e personelit për vitin 2023, me të gjitha pozitat e aprovuara dhe të shpërndara sipas kërkesave dhe nevojave të KPK-së dhe Prokurorit të Shtetit në njësitë përkatëse, i cili u miratua nga anëtarët e këtij Komisioni.



Komisioni shqyrtoi dhe aprovoi edhe Raportin vjetor financiar për vitin 2022, duke u fokusuar kryesisht në sqarimet dhe arsyetimin e shpenzimeve për secilën kategori dhe program buxhetor, të cilin ia rekomandoi për aprovim Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Aktivitetet e Sekretariatit të KPK-së

Sekretariati i KPK-së, gjatë muajit janar, ka përgatitur Raportin për përmbushjen e aktiviteteve të Këshillit Prokurorial për vitin 2022 në PKZMSA dhe ka zhvilluar një takim me përfaqësues të projektit EUKOJUST për mekanizmin e raportimit për zbatimin e Strategjisë për sundimin e Ligjit.

Gjithashtu, SKPK-ja në aspektin e ngritjes së kapaciteteve profesionale ka vazhduar ofrimin e trajnimit për vënien në zbatim të SMIL-it në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit për regjistrimin e veprimeve të lëndës në SMIL.